

REPUBLICA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8/2020 (JR)
Nr. 8/9 regj.

Tiranë më 28.07.2021

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se sot, më datë 27.07.2021, në seancën e thirrur në orën 10.00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri 8/2020 (JR), datë 07.02.2020, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Arben Vrioni kundër vendimit nr. 214, datë 22.11.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ditën e **mërkurë, datë 15.09.2021, ora 10:00.**

Kolegji i Posaçëm i Apelit e mori këtë vendim, të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e gabimit procedural të kryer nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konkretisht, mungesa e nënshkrimit të një prej anëtareve të trupit gjykues në vendimin objekt shqyrtimi, dhe për t’i garantuar subjektit të rivlerësimit mbrojtjen e të drejtave të tij themelore, në përputhje me nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.


Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykues
Relator i Çështjes
Anëtare
Anëtare
Anëtar

Rezarta Schuetz
Ardian Hajdari
Ina Rama
Natasha Mulaj
Sokol Çomo



Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet



e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE**



REZARTA SCHUETZ

